

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr. 638 Rep

Nr. 13 Kol

KONTRATE SHITJE

Sot. me date, 04.03.2002 (dy mijë e dy), u paraqiten para meje noteres se Dhomes Noterise Tirane Pranvera KARAFILLI, me seli ne rruga: "M. Shyri", palet kontratuese me cilesite si me poshte:

PALA SHITSE: Ikbale Male e bija e Ibrahimit, i lindur ne Tirane, me 30/01/1956 i identifikuar me ane te pasaportes NR1508145

PALA BLERSE : Petraq Pavllo , i biri i Pirros, i lindur ne Vuno, me 23.08/1953. i identifikuar me ane te leter njoftimit NR UG 410035

Palet kontraktuese kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuatash ne baze te nenit 705e vijuesa te Kodit Civil .

Shitësi Ikbale Male eshte ortak i vetem dhe Administrator e shoqerise "ENPI" sh.p.k e regjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Gjykatën e Tiranës me vendimin, 22594, date 14.01.2000 dhe zoteron 100% te kotave te kapitalit te kesaj shoqerise. Shiteshi Ikbale Male i shet blersit Petraq Pavllo 50 % te kotave te kapitalit te shoqerise "ENPI" sh.p.k me vleften nominale te tij duke humbur cdo te drejte mbi kete pjese te kapitalit prej 50 %.

Bleresi Petraq Pavllo pranon blerjen e kuotave te kapitalit perkatsisht 50 % nga zoti Ikbale Male dhe keshtu duke blere keto kuota behet zoterues mbi kapitalin e shoqerise "ENPI" sh.p.k ne masen 50 % te kuotave te gjithë kapitalit te shoqerise ne vleften 50 000 (pesedhjete mijë) lekë.

Ne kete menyre nuk preket dhe kapitali i nevojshem per te qene kjo shoqeri ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Me realizimin e kesaj kontrate shitje, shiteshi Ikbale Male i jep te drejte pronesie mbi Shoqerine ne masen 50% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerise, nepermjet transferimit me shitje te kuotave te tij, te cilat i kalojne zotit Petraq Pavllo ne masen 50 % te kapitali te saj, duke u bere ky i fundit ortak i shoqerise "ENPI" sh.p.k. Ne kete menyre zoterinjte Ikbale Male dhe Petraq Pavllo jane ortakë te shoqerise "ENPI" sh.p.k ne vleften 50 % me 50%.

Kjo eshte nje kontrate e shitblerje kuotash e perpiluar ne tre kopje dhe pasi lexohet me ze te larte dhe gjendet ne perputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese. nenshkruset rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUESE

BLERESI:

SHITESI:

NOTERE

Petraq Pavllo

Pranvera Karafilli

Q. H. H.

Ikbale Male

